



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.06.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Marisa SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “**Rehabilitimi i rrugëve me asfalt**”, Nr. i prokurimit- 632-23-440-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-005 -511, **nxjerr:**

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: **Marisa SH.P.K.**, e dt.05.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Rehabilitimi i rrugëve me asfalt**”, Nr. i prokurimit- 632-23-440-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-005 -511, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 31.05.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË** , i publikuar me datë: **31.05.2023;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me procedurat e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Marisa SH.P.K.**, me dt.05.06.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Rehabilitimi i rrugëve me asfalt**”, Nr. i prokurimit- 632-23-440-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-005 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.06.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pretendimi juaj se kërkesat e Autoritetit kontraktues për makineritë janë deskriminuese, është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues nuk ka vendosur limit fiks për paisje dhe është Autoriteti kontraktues ai që vendos kriteret dhe specifikat që mendon se janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të një aktiviteti.
- Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, sepse ka kërkuar që automjet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit me afat valid, shkelje do të ishte po të mos kërkohej një gjë e tillë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

